



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
NJËSIA PËRGJEGJËSE E SINJALIZIMIT**

RREGULLORE

PËR

**PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË HETIMIT ADMINISTRATIV TË
SINJALIZIMIT DHE MEKANIZMAT E MBROJTJES SË
KONFIDENCIALITETIT**

Bazuar në Ligjin 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; Nenin 74 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, hartohet rregullorja për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit, me përmbajtje sa më poshtë vijon:

Kreu I – Dispozita të përgjithshme

1. Objekti

1.1 Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit si dhe mbrojtjen nga hakmarrja në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

2. Njësia përgjegjëse e sinjalizimit

2.1 Njësia përgjegjëse e sinjalizimit përbëhet dy persona të emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së, sipas përbërjes dhe strukturës së organizatës, të trajnuar posaçërisht në fushën e mbrojtjes së sinjalizuesve.

2.2 Njësia përgjegjëse e sinjalizimit ka si funksion parësor regjistrimin, hetimin administrativ dhe shqyrtimin e sinjalizimeve, sipas kësaj rregulloreje dhe në përputhje të plotë me ligjin Ligjin 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

2.3 Njësia përgjegjëse e sinjalizimit mund ti kërkoj Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së, për raste të veçanta të kryerjes së procedurës së shqyrtimit të hetimit administrativ, përfshirjen pranë saj të personave profesionistë në fusha të caktuara.

3. Sinjalizim

3.1 Sinjalizimi është vënia në dijeni e njësisë përgjegjëse të sinjalizimit për fakte, veprime, praktika të paligjshme apo të dyshuara për korrupsion, të cilat sinjalizuesi i ka zbuluar gjatë kryerjes së punës së tij.

3.2 Sinjalizimi bëhet me çdo mjet komunikimi, në formë të shkruar ose deklarohet verbalisht para njësisë përgjegjëse dhe dokumentohet me shkrim nga anëtarët e kësaj të fundit.

3.3 Sinjalizimi përmban të paktën:

a) të dhënat e identitetit të sinjalizuesit;

b) të dhënat e kontaktit të sinjalizuesit;

c) përshkrimin e fakteve e të rrethanave të njohura nga sinjalizuesi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, shoqëruar me provat përkatëse, për aq sa është e mundur;

ç) referimin përkatës në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, për aq sa është e mundur, nga sinjalizuesi, të veprës ose praktikës së dyshuar të korrupsionit;

3.4 Në rastet kur sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së mësipërme, sinjalizuesit i kërkohet me shkrim të korrigjojë këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim.

4. Sinjalizues

4.1 Sinjalizues është individ i cili është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë në ISSH-së, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose

kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.

4.2 Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në ISSH, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, se mund të përbëjë korrupsion.

4.3 Sinjalizuesi e kryen sinjalizimin në kushtet e mirëbesimit dhe nuk motivohet nga interesi personal apo për të dëmtuar dikë tjetër.

Kreu II – Kryerja e sinjalizimit dhe mbrojtja e sinjalizuesve

1. Kryerja e sinjalizimit

1.1 Sinjalizimi kryhet në pëputhje të plotë me përcaktimet në Kreun I, Pika 3 të kësaj rregulloreje, si dhe sipas përcaktimeve në nenin 7 të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

1.2 Sinjalizimi është një veprim vullnetar dhe askush nuk mund të detyrohet të sinjalizojë.

1.3 Kryerja e sinjalizimit kryhet në çdo formë komunikimi që sinjalizuesi e shikon të arsyeshme. Në mënyrë që sinjalizimi të konsiderohet i vlefshëm, nevojitet që sinjalizuesi të kontaktojë fizikisht me Njësinë Përgjegjëse të Sinjalizimit.

1.4 Sinjalizuesi mund të zgjedhi të kryej sinjalizimin e tij në mënyrë anonime. Në mënyrë që sinjalizimi të konsiderohet i vlefshëm, nevojitet që sinjalizuesi të paraqesi gjithashtu shkaqe të arsyeshme të anonimatit dhe të dhënat e sinjalizuara të përbëjnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin apo praktikën e dyshuar të korrupsionit.

1.5 Sinjalizimi mund të kryet si sinjalizim i brendshëm apo i jashtëm sipas përcaktimeve të mëposhtme:

- a)** Sinjalizim i brendshëm konsiderohet kur sinjalizimi kryhet pranë Njësisë Përgjegjëse të Sinjalizimit në ISSH.
- b)** Sinjalizim i jashtëm konsiderohet kur sinjalizimi kryhet pranë ILDKPKI-së, në të gjitha këto raste sinjalizuesi duhet të paraqesi me shkrim shkaqet dhe rrethanat të cilat e detyruan të bëjnë këtë zgjedhje.

1.6 Sinjalizimi duhet të përmbajë fakte e prova të arsyeshme të cilat vërtetojnë se është një akt që udhëhiqet nga interesi publik dhe jo nga motive apo pakënaqësi personale.

2. Mbrojtja e sinjalizuesve

2.1 Një sinjalizim është i mbrojtur në të gjitha ato raste kur shkelja është raportuar duke përdorur procedurën e duhur.

2.2 Në mënyrë që sinjalizuesi të jetë i mbrojtur duhet të sinjalizojë vetëm tek personat dhe institucionet e përcaktuara në Kreun II, Pika 1.5 të kësaj rregulloreje, si dhe në Ligjin 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

2.3 Nëse sinjalizimi kryhet në çdo organizatë tjetër publike apo private që nuk është përcaktuar në Kreun II, Pika 1.5 të kësaj rregulloreje, sinjalizuesi humbet të drejtën e mbrojtjes nga viktimizimi sipas përcaktimeve të nenin 18 të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

2.4 Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, paraqet kërkesë për mbrojtje tek Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit në ISSH.

2.5 Njësia përgjegjëse merr menjëherë masat dhe në çdo rast jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes.

2.6 Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas përcaktimeve të nenit 18, pika 1 e Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, mbrohet ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij nga persona apo strukturat drejtuese në ISSH, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a) shkarkimin nga puna;
- b) pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
- c) transferimin brenda ose jashtë strukturës organizative ku punon;
- ç) uljen në detyrë;
- d) uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
- dh) humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
- e) mosnëritjen në detyrë;
- ë) heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;

- f) vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
- g) forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.

2.7 Të drejtat dhe interesat e sinjalizuesve mbrohen në mënyrë të besueshme, të efektshme dhe të përshtatshme.

2.8 Sinjalizuesi informohet nga Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit, në mënyrë të plotë dhe në gjuhë të kuptueshme, për të drejtat dhe mbrojtjen e ofruar nga ISSH në përputhje të plotë të përcaktimeve në Ligjin 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Kreu III – Vlerësimi i sinjalizimit dhe procedura e hetimit administrativ

1. Vlerësimi i sinjalizimit

1.1 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit pasi merr sinjalizimin, kryen vlerësimin e tij. Vlerësimi i sinjalizimit kryhet në bazë të katër komponentëve kryesorë siç janë: burimi, formaliteti, qëllimi dhe përmbajtja e sinjalizimit.

1.2 Vlerësimi burimor i sinjalizimit kryhet në bazë të përcaktimeve të pikës 13, neni 3 i Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; si dhe pikës 3.1, Kreu I i kësaj rregulloreje. Nëse burimi i sinjalizimit nuk është sipas përcaktimeve të sipër cituara Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ në përputhje me germën “a” pika 1 e nenit 14 të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

1.3 Vlerësimi i formalitetit të sinjalizimit kryhet në bazë të përcaktimeve të pikës 1, neni 7 i Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; si dhe pikës 3.2, Kreu I i kësaj rregulloreje. Nëse paraqitja e sinjalizimit nuk është sipas përcaktimeve të sipër cituara Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ në përputhje me germën “a” pika 1 e nenit 14 të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

1.4 Vlerësimi i qëllimit të sinjalizimit kryhet në bazë të përcaktimeve të pikës 1.6, Kreu II i kësaj rregulloreje. Nëse qëllimi i sinjalizimit nuk është sipas përcaktimeve të sipër cituara Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ në përputhje me germën “c” pika 1 e nenit 14 të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

1.5 Vlerësimi i përmbajtjes së sinjalizimit kryhet në bazë të përcaktimeve të germa “b”, pikës 2, neni 6 i Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”; si dhe pikës 3.3, Kreu I i kësaj rregulloreje. Nëse përmbajtja e sinjalizimit nuk është sipas përcaktimeve të sipër cituara Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit ka të drejtë të mos fillojë hetimin administrativ në përputhje me germën “a” pika 1 e nenit 14 të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

2. Trajtimi i sinjalizimit

2.1 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit me marrjen e sinjalizimit kryhen hapjen e dosjes hetimore, kodifikimin e sinjalizuesit me një kod alpha-numerik 10 shifëror (shembull: ISSH000001), regjistrimin në regjistrin themeltar të çështjeve të sinjalizuara tip (bashkangjitur kësaj rregulloreje) në të cilin vendosen të gjitha shënimet e nevojshme.

2.2 Lidhja e sinjalizuesit me kodifikimin e tij, mbahet në regjistrin e kodifikimeve tip (bashkangjitur kësaj rregulloreje), i cili administrohet në mënyrë të veçantë e të pavarur me dosjet hetimore nga Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit.

2.3 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit pas vlerësimit të sinjalizimit vendos nëse do të fillojë ose jo procedurën e hetimit administrativ.

2.4 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit mund të mos fillojë hetim administrativ nëse gjen elementë të përcaktuar në pikën 1, të nenit 14 të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” siç janë rastet:

- a.** sinjalizimi nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar dhe sinjalizuesi nuk korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për korrigjim;
- b.** sinjalizimi përmban fakte dhe rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr. 60/2016, sipas nenit 3, pika 6, të tij;
- c.** kur nga përmbajtja e sinjalizimit del haptazi se nuk ka elemente të kundërvajtjes administrative ose të veprës penale.

2.5 Për çdo rast i cili nuk përkufizohet në pikën 2.4, Kreu III i kësaj rregulloreje, Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit fillon hetimin administrativ sipas

përcaktimeve të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” si dhe të Ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

3. Procedura e hetimit administrativ

3.1 Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejtë të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit, përveç kur nga rrethanat kërkohet një afat më i gjatë.

3.2 Gjatë periudhës së hetimit administrativ, Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit shqyrton dhe vlerëson pretendimet e ngritura nga sinjalizuesi në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Për këtë qëllim, Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit ka të drejtë të kërkojë informacione dhe dokumente, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata ose të pyesë persona në dijeni me rrethanat e çështjes ose të konsultohet me ekspertë të fushave të ndryshme.

3.3 Në hetimin administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo person tjetër i tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë dhe të sinjalizuarin, nëse vlerësohet e nevojshme nga drejtuesi i hetimit.

3.4 Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohet një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, si dhe:

- a) mund të japë deklarata me shkrim, argumente ose opinione;
- b) mund të konsultohet me dosjen e hetimit;
- c) ka të drejtë të dëgjohet në lidhje me pretendimet e tij.

3.5 ISSH duhet të vendosë në dispozicion të hetimit të dhënat, dokumentacionin dhe provat e zotëruara prej saj.

3.6 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga momenti i kryerjes së veprimit.

3.7 Nëse në përfundim të hetimit administrativ të sinjalizimit nga Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar përbën ose mund të përbëjë një shkelje administrative, sipas ligjit, Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit sipas rastit, vë në dijeni organin kompetent.

3.8 ISSH, në bashkëpunim me ILDKPKI-në, marrin masa të menjëhershme, të çastit dhe për aq sa është e mundur, për të parandaluar ose penguar vazhdimin e pasojave të dëmshme nga veprimi ose praktika e dyshuar e korrupsionit të sinjalizuar.

3.9 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit, sipas rastit, kërkon nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së, angazhimin edhe të personave të tjerë, punonjës të ISSH-së, të cilët do të përfshihen dhe do të jenë pjestar të grupit të punës në hetimin administrativ.

4. Përfundimi i hetimit administrativ

4.1 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit ka të drejtë të përfundojë hetimin administrativ nëse:

a) gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar. Në këtë rast, Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit njofton menjëherë prokurorinë; organet e tjera ligjzbatuese e kontrolluese.

b) sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6 të Ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe se gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i pa bazuar.

Kreu IV – Bashkëpunimi, Komunikimi dhe Raportimi

1. Bashkëpunimi

1.1 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit në kryerjen e detyrave funksionale bashkëpunon ngushtësisht me organe të tjera shtetërore siç janë:

- a) ILDKPKI-në;
- b) Drejtorinë e Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë;
- c) Organin e Prokurorisë;
- d) Policinë e Shtetit.

2. Komunikimi

2.1 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit gjatë procedurës së vlerësimit e trajtimit të sinjalizimit, por edhe gjatë hetimit administrativ komunikon me:

- a) Sinjalizuesin;
- b) Persona në dijeni për rrethanat e çështjes;
- c) Ekspertë të fushave të ndryshme për të cilat kryhet hetimi administrativ;
- d) Drejtuesit e ISSH-së.

3. Raportimi

3.1 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit raporton pranë ILDKPKI – së jo më vonë se data 15 janar i çdo viti për aktivitetin vjetor të realizuar.

3.2 Përveç raportimit vjetor Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit raporton pranë ILDKPKI – së, sa herë që i kërkohet.

Kreu V – Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale

1. Konfidencialiteti

1.1

1.2 Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.

1.3 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit duhet të ruajnë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar te persona të tretë brenda ose jashtë ISSH-së, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

1.4 Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit, në komunikimet me ISSH-në dhe strukturat e varësisë ku punon sinjalizuesi, ose/dhe me çdo subjekt apo autoritet tjetër, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.

1.5 Çdo person, i cili merr informacion konfidencial nga Njësia Përgjegjëse e Sinjalizimit, ka të njëjtin detyrim për përpunimin dhe ruajtjen e informacionit në mënyrë konfidenciale.

2. Mbrojtja e të dhënave personale

2.1 Të dhënat personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ përpunohen vetëm për qëllim të ligjit 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”. Në çdo rast, përpunimi i të dhënave personale kryhet sipas parimeve dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Astrit Hado